



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 40/3 Prot.

Tiranë, më 29/2 /2012

Lënda: Rekomandim për "Agjencia e Sigurimit të Depozitave".

REKOMANDIM

Nr. 07, datë 29/02/2012

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, "Agjencia e Sigurimit të Depozitave",

KONSTATOVA

Më datë 09.02.2012, bazuar në Urdhërin e Komisionerit Nr. 15, datë 08.02.2012, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "Agjencia e Sigurimit të Depozitave", me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit/ve dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- **Qëllimet e përpunimit të të dhënave personale prej kontrolluesit "Agjencia e Sigurimit të Depozitave":**
- ✚ Verifikimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale, bazuar në nenet 5, 6, 7 të Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në lidhje me:
- ✚ Qëllimin/met e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të njoftuara;
- ✚ Verifikimin nëse mblidhen dhe përpunohen të dhëna personale vetëm për qëllimet: Menaxhim të burimeve njerëzore dhe Mbikqyrje e ambienteve me CCTV;
- ✚ Kategoritë e të dhënave që përpunohen për qëllimet e njoftuara: Menaxhim të burimeve njerëzore dhe Mbikqyrje e ambienteve me CCTV;
- ✚ Nëse të dhënat janë mbledhur për qëllime të tjera, cilat janë kategoritë e subjekteve dhe kategoritë e të dhënave që ju përpunohen;

- ✚ Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
- ✚ Saktësinë e të dhënave që përpunohen;
- ✚ Përhapjen e të dhënave të mbledhura e të përpunuara, tek të tretët;
- ✚ Transferimin ndërkombëtar të këtyre të dhënave sensitive;
- ✚ Marrjen e pëlqimit të shkruar nga subjektet që ju përpunohen të dhënat sensitive;
- ✚ Baza ligjore e përpunimit të këtyre të dhënave.
- **Siguria dhe politikat e privatësisë për përpunimin e të dhënave “sensitive”, bazuar në nenet 20, 27 dhe 28 të Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në lidhje me:**
 - ✚ Caktimin e ndonjë përpunuesi të të dhënave sensitive dhe mbi çfarë akti ligjor;
 - ✚ Vendosjen e kontrollit në aksesin e të dhënave sensitive të përpunuara dhe përgjegjësitë në administrimin e këtyre të dhënave;
 - ✚ Nivelin e sigurisë fizike dhe teknike të sistemit të përgjithshëm ose të veçantë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave sensitive;
 - ✚ Verifikimin, nëse ka në fuqi ndonjë rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale ose të ketë rregulla që janë përfshirë në rregulloren e brendshme, veçanërisht në përpunimin e të dhënave sensitive;
 - ✚ Verifikimin, nëse janë parashikuar dhe zbatohen politikat e mbrojtjes së të dhënave nëpërmjet “*konfidencialitetit*”.
- **Instalimi, përdorimi, mbikqyrja dhe regjistrimi me anën e “Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi” (CCTV), në ambjentet dhe në territorin e kontrolluesit “Agjencia e Sigurimit të Depozitave”:**
 - ✚ Verifikimi i përdorimit të këtyre kamerave bazuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe në Udhëzimin Nr. 3, datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme” në lidhje me:
 - ✚ Qëllimin e përpunimit të imazheve, si të dhëna personale me karakter të veçantë fizik;
 - ✚ Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
 - ✚ Saktësinë dhe qartësinë në përpunimin e imazheve, gjatë vëzhgimit dhe regjistrimit të tyre;

- ⬇ Kohën e ruajtjes së imazheve filmike apo fotove të gjeneruara nga sistemi i ruajtjes dhe i regjistrimit;
- ⬇ Kategoritë e subjekteve që ju përpunohen imazhet dhe mënyrat e përpunimit të tyre për identifikimin e subjekteve;
- ⬇ Përhapjen e të dhënave të mbledhura e të përpunuara me anën e CCTV-ve, tek të tretët;
- ⬇ Numrin e kamerave të vendosura në ambientet dhe në territorin e kontrolluesit dhe nëse ka instalime të kamerave të fshehta.

Komisioneri Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast, si dhe provat e administruara, vëren se:

1-Kontrolluesi, *“Agjencia e Sigurimit të Depozitave”*, nuk ka përfunduar plotësisht detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në këto kushte nuk është zbatuar neni 21/1, 22/c dhe 23, i Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, (Rubrika 5), *“...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë”*. Neni 21/c: *“Njoftimi duhet të përmbajë:c) kategoritë e subjekteve të të dhënave”*.

Gjithashtu, bazur në nenin 25 të Ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte e konsiderojmë shkelje të rëndë përpunimin pa njoftuar e pa u regjistruar më parë në Regjistrin Qëndror të Subjekteve Kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit. Gjithashtu, fakti që bërja publike, bazuar në nenin 26/2 të Ligjit, është penguar për shak të mos njoftimit të këtij përpunimi për kategorinë *“Anëtarë të këshillit të bordit”*, mund të ketë penguar referencat e mundshme që këta subjekte të dhënash mund të kishin bërë te gjendja e përpunimit për kategorinë që ata i përkasin.

2- Kontrolluesi, *“Agjencia e Sigurimit të Depozitave”*, nuk ka të hartuar një rregullore të shkruar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe politikat e konfidencialitetit, në zbatim të nenit 27/2 “c” të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” : *“udhëzon operatorët pa përjashtim për detyrimet që kanë në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave,përfshirë dhe rregullat për sigurinë e të dhënave”*, si dhe mungojnë politikat e mbrotjes së të dhënave nëpërmjet konfidencialitetit, të parashikuara në Nenin 28 të Ligjit.

Hartimi i një Rregulloreje të veçantë është një pjesë e rëndësishme e masave bazë të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi. Në këtë rregullore përcaktohen mekanizma për kontrollin e aksesit, identifikimin e saktë të çdo përdoruesi të të dhënave, garantimin që informacioni i mbledhur do të përdoret sipas rregullave të mirëpërcaktuara. Me anën e kësaj Rregulloreje duhen përcaktuar në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit, procedurat e përpunimit, sistemin e arkivimit, etj, si dhe politika të veçanta për ruajtjen e konfidencialitetit. Një rregullore e tillë

është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjektit të të dhënave gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

3- Kontrolluesi, *“Agjencia e Sigurimit të Depozitave”*, nuk ka një kontratë me kompaninë që ka instaluar dhe mirëmban sistemin e kamerave survejuese, dhe për pasojë nuk ka si të ketë parashikuar të drejtat dhe detyrimet që palët kanë, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo çënon rëndë sigurinë e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave (neni 27/1).

Edhe kjo mangësi shihet si problematikë që sjell pasoja që çënojnë sigurinë e të dhënave që përpunohen nëpërmjet kamerave të vëzhgim-regjistrimit (CCTV). Ju si kontrollues nëpërmjet një kontrate duhet të përcaktoni saktë përgjegjësitë e kompanisë që do ju ofrojë këtë shërbim, pasi sistemet e menaxhimit të CCTV duhet të kenë standarte të larta sigurie teknike dhe përgjegjësie nga ana e kompanisë (përpunuesit) që do t'i menaxhojë pamjet filmike të regjistruara apo fotot e nxjerra nga procesi, kohën e ruajtjes së tyre, mënyrën e shkatërrimit, kontrollin e aksesit (personin që ka akses), ruajtjen e konfidencialitetit, etj.

4) Kontrolluesi, *“Agjencia e Sigurimit të Depozitave”*, në ambientet e punës, ku ka instaluar sistemin e kamerave survejuese, nuk ka vendosur në këto ambiente tabela informuese me qëllim plotësimin e detyrimit të përcaktuar nga neni 18 *“Detyrimi për informim”* i Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, si dhe nga Udhëzimi nr.3, datë 05.03.2010, mbi, *“Sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”*, pika 5, sipas të cilës *“Të gjithë punonjësit që punojnë nën vëzhgimin e kamerave duhet të njoftohen nga punëdhënësi me shkrim”*.

Në këto kushte vlerësojmë se mosinformimi i subjekteve që ju përpunohen të dhënat me karakter të veçantë fizik, pra imazhet dhe fotot nëpërmjet kamerave CCTV, është një mangësi që çënon të drejtat e këtyre kategorive subjektsh dhe duhen marrë masa për pushimin e këtij cënimi. Çdo subjekt i këtij përpunimi ka të drejtë të jetë në dijeni që në ambientet tuaja imazhet e tij po regjistrohen dhe që janë objekt i përpunimit nga ana juaj, si dhe qëllimit përse po realizohet përpunimi.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, si dhe neneve 107-109 të K.Pr.Administrative,

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 21-22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, të realizoni njoftimin për përpunimin e të dhënave për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale *“Anëtarë të këshillit të bordit”*, brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh;
2. Në zbatim të neneve 27/2 “c” dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, të hartohet dhe të miratohet një Rregullore e Brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh. Zyra e Komisionerit ofron asistencën e saj për hartimin e kësaj Rregulloreje;
3. Në zbatim të nenit 27, të lidhet një kontratë me kompaninë që ka instaluar dhe mirëmban sistemin e kamerave survejuese, ku të parashikohen të drejtat dhe detyrimet që palët

kanë, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh;

4. Në zbatim të Nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*”, të vendosen tabela informuese (sipas modelit tip të miratuar me Urdhrin nr. 33 datë 27/06/2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale nëpërmjet sistemit me kamera CCTV, në të gjitha ambientet tuaja ku ushtroni veprimtarinë dhe përdorni CCTV, brenda një periudhe prej 10 (dhjetë) ditësh;
5. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit ”*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave*”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

